

1 E enjte, 13 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal dua të them që të katërt të akuzuarit janë në
13 seancën e gjyqit sot.

14 Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes
15 1DW-009.

16 Përpara se të fillojmë me provat e dëshmitarit, Trupi
17 Gjykues dëshiron të trajtojë disa çështje paraprake. Trupi
18 Gjykues do të nxjerrë dy urdhra gojorë.

19 Urdhri i parë gojor.

20 Më 25 janar 2025, Trupi Gjykues urdhëroi Njësinë e
21 Shërbimeve të Gjuhëve që të verifikonte përkthimin e
22 dokumentit P00943_ET dhe P00944_ET. Pas këtij procesi
23 verifikimi, ZPS-ja, më 29 gusht 2025 kërkoi që këto dokumente
24 të zëvendësoheshin me përkthime të rishikuara që i janë
25 nxjerrë Mbrojtjes, përkatësisht këto dokumentet janë REG01038

1 deri në REG01126 dhe REG1006 deri në REG1007_ET_RV.

2 A mund të konfirmoj që nuk ka kundërshtime nga palët?

3 Përderisa nuk dëgjojmë kundërshtime, pasi ka dëgjuar
4 palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykses urdhëron që prova
5 P00943_ET dhe P00944_ET të zëvendësohen me përkthimet e
6 rishikuara në paketën e dokumenteve 1104.

7 Ky është urdhri i parë gojor i Trupit Gjykses.

8 Urdhri i dytë i Trupit Gjykses.

9 Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Thaçit ka bërë një
10 kërkesë në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes së
11 Thaçit 1DW-005 në parashtrimin F03513 dhe, së dyti, ZPS-ja ka
12 bërë një kërkesë në lidhje me të njëjtin dëshmitar në
13 parashtrimin F03515.

14 Trupi Gjykses vëren se përderisa këto që prej kohës kur
15 janë parashtruar këto kërkesa, Mbrojtja e Thaçit ka informuar
16 Trupin Gjykses që nuk synon të përdorë më këto dokumente apo
17 të mbështetet në këtë dëshmitar. Trupi Gjykses deklaron se të
18 gjitha ato parashtrime janë të tejkaluara.

19 Ky është urdhri i dytë gojor i Trupit Gjykses.

20 Tani, në lidhje me parashtrimin F03572, përgjigja e
21 Prokurorisë ndaj kërkesës së dytë të Mbrojtjes së Thaçit për
22 pranimin e dokumenteve përmes provave jo gojore, z. Misetic,
23 ju thatë që donit të bëni parashtrime në kundërpërgjigje. A
24 jeni gati që t'i bëni këto parashtrime tani?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Dua që të trajtoj vetëm një

1 dokument, që është dokumenti 26 në provat jогоjore tonat, që
2 është F0355 Shtojca 1.

3 Prokuroria thotë që përmbledhja e dëshmisë që është dhënë
4 në Gjykatë dhe, në fakt, në dokument thuhet që ky person ka
5 folur me një gazetë. Dhe në të thuhet që ai "flet për Novosti"
6 dhe kjo fillon në paragrafin e dytë dhe vazhdon më tej në
7 dokument, pra, thuhet edhe këtu citoj:

8 "... ka dhënë dëshmi për Novosti lidhur me
9 bashkëpunëtorët e tij" e të tjerë. Pra, ky material që
10 përfshihet ose ky informacion që përfshihet është material që
11 i është dhënë drejtpërdrejt një gazete dhe nuk është
12 përmbledhje e dëshmisë që ka dhënë personi në Gjykatë. ky
13 është qëndrimi ynë lidhur me këtë dokument dhe ne parashtrojmë
14 që ky është i pranueshëm si informacion.

15 Dhe, ndërkohë që kam këtu në këmbë, dua që të më jepni 30
16 sekonda që të trajtoj diçka që ngriti Gjykatësi Mettraux dhe
17 sa i takon dallimit midis konfliktit të armatosur të brendshëm
18 dhe konfliktit të armatosur ndërkombëtar, thjesht dua që të
19 japim qëndrimin tonë për procesverbal. Në qoftë se na jepni
20 leje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm 30
22 sekonda atëherë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] 30 sekonda do përdor vetëm. Ne
24 duam të themi që qasja jonë dhe qëndrimi ynë është që,
25 aktualisht, nuk është e nevojshme të bëhet asnjë lloj dallimi

1 në faktet e kësaj çështjeje dhe sepse fundi i një konflikti të
2 armatosur ndërkombëtar dhe fundi i një konflikti të armatosur
3 kombëtar nuk është se kanë ndonjë dallim shumë të madh për
4 arsye të kësaj çështjeje sepse KFOR-i ka qenë përgjegjës për
5 parandalimin e çdo konflikti që mund të ndodhte në Serbi dhe
6 në Kosovë dhe, për rrjedhojë, përpjekjet nga Serbia për të
7 vazhduar një konflikt të armatosur me UÇK-në do të çonin në
8 përpjekje ose konflikte të Serbisë me KFOR-in dhe për këtë
9 arsye ne mendojmë që nuk duhet bërë dallimi dhe nuk ka ndonjë
10 dallim ndërmjet konfliktit të armatosur kombëtar dhe
11 ndërkombëtar.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin,
13 Misetic.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të
15 vazhdojmë atëherë me dëshmitarin.

16 Do i lutesha Sekretares të sjellë dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
19 Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
22 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtohet që të përpigjeni t'i
23 jepni përgjigje pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë
24 se nuk e kuptoni një pyetje të caktuar, lirisht mund t'i
25 kërkonit Avokates që të shpjegojë pyetjen ose mund të kërkonit

1 që të përsëritet përsëri pyetja. Po ashtu, duhet të kujtoni që
2 jepni bazën e njohurive, të fakteve dhe rrethanave për të
3 cilat do të pyeteni.

4 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin për të thënë të
5 vërtetën sikurse e keni deklaruar në deklaratën solemne që
6 lexuat dje.

7 Ju lutem mbani parasysh gjithashtu që duhet të flisni
8 pranë mikrofonit, të bëni një pauzë prej pesë sekondash
9 përpara sesa t'i përgjigjeni pyetjeve dhe të flisni me ritëm
10 të ngadaltë për t'u kapur përkthyesit.

11 Nëse e keni të nevojshme për të bërë ndonjë pushim gjatë
12 gjithë kohës, mund të na e bëni me dije këtë gjë. Sa për
13 informimin tuaj ne do të bëjmë një pushim të shkurtër prej
14 dhjetë minutash në orën 10.00, pastaj në orën 11.00 do bëjmë
15 pushim e rregullt prej gjysmë ore.

16 Ju lutem dëgjojini me vëmendje pyetjet e znj. Tavakoli.

17 Znj. Tavakoli, mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
19 Gjykatës.

20 DËSHMITARI: MICHAEL DURKEE [Vijon]

21 Pyetje nga znj. Tavakoli: [Vazhdim]

22 PY. Mirëmëngjes, z. Durkee. Dje kur mbaruam ditën, ne po
23 flisnim për dhunën pas luftës në Kosovë. Do vazhdoj me të
24 njëjtën temë sot.

25 Në paragrafin 17 të deklaratës tuaj, ju keni përshkruar

1 dhunën në verën e vitit 1999 dhe keni thënë, këtu citoj fjalët
2 tua, "kishte një reagim shumë të gjerë social që nuk mund të
3 kontrollohej as nga KFOR-i dhe as nga udhëheqësit e UÇK-së". A
4 mund të na shpjegoni çfarë keni dashur të thoni kur jeni
5 shprehur se kishte "një reagim të gjerë social"?

6 PË. Perceptimi im, po gjithashtu edhe perceptimi i UNMIK-ut
7 dhe i KFOR-it ishte që refugjatët që po ktheheshin, pra, që
8 ishin refugjatët që ishin dëbuar nga forcat e Milosheviqit nga
9 Kosova në dimër, në dimrin e egër të vitit 1998, 1999, po
10 ktheheshin në fshatrat e tyre dhe po shikonin që shtëpitë e
11 tyre ishin shkatërruar, pronat e tyre ishin shkatërruar,
12 miqtë, shokët dhe fqinjët nuk është se ishin më aty. Pra,
13 kishte nivele të ndryshme të shkatërrimit të jetës së
14 përditshme dhe të zakonshme të shqiptarëve të Kosovës. Këto
15 ishin pasoja të rënda dhe të mëdha, shumë prej tyre reagues me
16 dëshirën për hakmarrje, me mëri, me inat e të tjerë.

17 PY. Në të njëjtin paragraf ju thoni që ky është "diçka që
18 është gjeneruar në nivel lokal që ishte motivuar nga hakmarrja
19 nga inatet personale, nga larja e hesapeve, nga vjedhjet
20 oportuniste të pronave dhe nga gjakmarrjet që shtriheshin në
21 kohë ndërmjet familjeve dhe grupeve kriminale".

22 T'i marrim pjesë pas pjese të gjithë fjalët e kësaj
23 fjalie. Kur thoni që janë motivuar nga hakmarrja, për çfarë
24 hakmarrje e keni fjalën këtu, Dëshmitar?

25 PË. Në qoftë se do e shikojmë pas atë çfarë ka ndodhur në

1 pranverën e vitit 1999 dhe veprimtaritë nuk kishin të bënë
2 vetëm thjesht me kontrollin e qeverisë serbe, po gjithashtu
3 edhe të grupeve paramilitare të cilat ishin zhvilluar në
4 popullsinë serbe në Kosovë dhe në shumë vende këta banorë
5 lokalë serbë në fakt po jepnin informacion sa i takon se ku
6 duhet të përqendroheshin forcat serbe. Kjo është diçka e cila
7 është dirigjuar kryesisht nga Ministria e Punëve të Brendshme.
8 Ndërkohë që kosovarët, shqiptarët e Kosovës po dëshmonin ose
9 po shikonin me sytë e veta që po trajtoheshin në këtë mënyrë
10 nga persona të cilët jetonin në rrethana të ngjashme në ato
11 fshatra dhe në ato qyteza, besoj se është e kuptueshme sepse
12 ata më pas kishin dëshirën për hakmarrje, sepse ndiheshin që
13 ishin tradhtuar dhe ishin viktimizuar nga persona që ishin
14 rritur bashkë me ta. Luftërat civile janë brutale dhe edhe në
15 këtë rast ishte një luftë civile brutale në atë nivel.
16 PY. Kur thoni që "ka pasur inate personale, larje hesapesh
17 dhe gjakmarrje që kishin zgjatur në kohë ndërmjet familjeve",
18 a mund të na shpjegoni çfarë doni të thoni me këtë gjakmarrje,
19 si lidhen këto me konfliktin, apo jo?
20 PË. Pra, duhet të bëhet dallimi, dhe dua që t'i referohem
21 gjithashtu traditës së Kanunit të shqiptarëve, idesë së nderit
22 personal, rëndësisë së mbrojtjes së nderit personal. Kjo donte
23 të thoshte se kur një anëtar i familjes ishte sulmuar ose
24 ishte cenuar nga veprimet e dikujt tjetër në të njëjtin fshat
25 ose në të njëjtin qytezë, pra, gjithë familja ndiente

1 përgjegjësinë që të lante hesapet. Dhe kushdo që ndiente
2 përgjegjësinë që duhet ta kishte mbrojtur atë anëtar
3 familjeje, pra, kishte tendencë që të përfshihej në një qasje
4 të tillë.

5 PY. Një pjesë e dhunës, sipas mendimit tuaj, e kishte
6 origjinën pikërisht nga kjo situatë sipas mendimit tuaj?

7 PË. Po dhe nuk është vetëm mendimi im. Po besoj që dhe
8 vlerësimi i KFOR-it dhe UNMIK-ut ishte pothuajse i njëjtë.

9 PY. Kur flisni për larje hesapesh, a flisni për larje hepash
10 për gjëra të cilat kanë ndodhur përpara konfliktit jo
11 domosdoshmërisht për incidente që mund të kenë ndodhur gjatë
12 konfliktit, çfarë shpjegimi keni ju lidhur me këtë?

13 PË. Në historinë e Kanunit, disa prej këtyre gjakmarrjeve ose
14 situatave të tilla mund të kenë zanafillën shumë breza më
15 përpara, nuk kanë të bëjnë domosdoshmërisht me konfliktin.

16 PY. Shkurtimisht na e thuaj pak si e kuptoni ju Kanunin?

17 PË. Theksohet shumë siguria, mbrojtja, avancimi i familjes
18 kundër situatave jo miqësore, sulmeve nga persona të tjerë dhe
19 familja është në bazë të gjithçkaje dhe ka rëndësinë më të
20 madhe nga çdo gjë tjetër.

21 PY. Si rezultat a pajtoheni me mua që kur vlerësohet
22 konflikti i një vendi të caktuar, do të duhet të merret
23 parasysh kultura e vendit përkatës kur bëhet vlerësimi i
24 situatës?

25 PË. Sigurisht që po.

1 PY. Ju këtu përmendni edhe klanet kriminale që kryenin disa
2 prej dhunës. Nga vinin këto grupe kriminale?

3 PË. Sipas mendimit tim, dhe sigurisht kjo mbështetet në
4 informacionet që janë dhënë nga persona që punonin për KFOR-
5 in, nga UNMIK-u e të tjerë. Pra, disa prej tyre ishin
6 organizata ose grupe kriminale që kishin kohë që ekzistonin,
7 që nuk është se kishin të bënë me luftën, por bëhej fjalë për
8 konflikte ndërmjet grupeve të ndryshme armiqësore ndaj njëri-
9 tjetrit të cilët mundoheshin që të depërtonin apo të kryenin
10 veprimtari në një fushë të konfliktit dhe pastaj kishte dhe
11 grupe të tjera të cilat funksiononin në një mënyrë të ngjashme
12 në të njëjtin vend ose në një vend të afërt. Kështu që këto
13 dua të them kur flas për grupet ose klanet kriminale,
14 domethënë, janë çështje të cilat jo domosdoshmërisht lidhen me
15 veprimtaritë, me konfliktin për luftën.

16 PY. Pra, përshkrimi i dhunës që dhatë juve, a është i njëjtë
17 me përshkrimin ose me mënyrën se si e kuptonte dhunën SACEUR,
18 apo shtetet e tjera të NATO-s të cilat ishin pjesë e SACEUR që
19 na e shpjeguat dje?

20 PË. Kjo ka qenë pjesë e fluksit të informacionit, shkëmbimit
21 të informacionit që në fund i jepej Gjeneralit Clark.

22 PY. Pra edhe këto element përfshiheshin, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Pra, këto ishin vlerësimet edhe të shteteve anëtare
25 individuale të NATO-s si, për shembull, Mbretëria e Bashkuar,

1 Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Irlanda e kështu me radhë?

2 PË. Po, ishte një pikëpamje e përgjithshme, kjo ishte një ide
3 e përgjithshme.

4 PY. Në paragrafin 18 të deklaratës, ju thoni që keni krijuar
5 përshtypjen që udhëheqja e UÇK-së nuk ishte në gjendje që të
6 kontrollonte dhunën sepse emocionet e popullatës së zhvendosur
7 ishin kaq shumë të forta, ndjesitë e tyre ishin kaq shumë të
8 forta sa që nuk kishte një zinxhir të mirëqenë dhe të fortë
9 komande brenda UÇK-së. Vlerësimi që nuk ishte një zinxhir të
10 konsoliduar të komandës brenda UÇK-së ishte vlerësimi juaj
11 personal apo ishte gjithashtu edhe përfundimi ose ideja e
12 SACEUR dhe shteteve anëtare të NATO-s?

13 PË. Përfundimi ku jam mbështetur unë për sa i takon prurjes
14 ose dhënies së informacionit, shkëmbimit të informacionit të
15 disponueshëm në SACEUR dhe në shtetet anëtare. Dhe, më duhet
16 të them, që vlerësimi për sa i takon njohurive të stafit
17 ushtarak dhe strukturave të komandës me informacionet që kisha
18 unë dhe me informacionet që ndaheshin ndërmjet shteteve
19 anëtare dhe gjithashtu ndërmjet shtabit të SACEUR. Ne kishim
20 këtë përshtypje dhe nuk ishte një strukturë solide ose të
21 konsoliduar komande që dikush, domethënë, të ishte në nivel të
22 lartë në Prishtinë dhe që të jepte urdhra të cilat më pas do
23 të çonin në veprimet ose në operacione të caktuara në terren
24 për zonat operative. Komandantët e zonave operative kishin
25 autonomi të konsiderueshme dhe ekzistonte vullneti i tyre për

1 të vepruar me kokën e tyre kur ata ta mendonin të

2 përshtatshme.

3 Domethënë, nuk kishte një zinxhir të konsoliduar komande
4 në kuptimin e koordinimit të autoritetit të drejtpërdrejtë të
5 komandës siç e kuptojmë atë në ushtrinë perëndimore.

6 PY. A mundej në atë kohë Hashim Thaçi ta ndalonte dhunën?

7 PË. Nuk kishte kompetencë, nuk kishte autoritet Hashim Thaçi
8 për ta bërë këtë gjë në atë kohë.

9 PY. Po pse e thoni ju këtë gjë?

10 PË. Sepse në ato ditë, pra, pas tërheqjes së serbëve dhe të
11 forcave serbe, UÇK-ja ishte në mes të situatës ku duhej që të
12 realizonin sipërmarrjet dhe premtimet që i kishin KFOR-it së
13 bashku me Gjeneralin Jackson. Ndërkohë që kishte luftëtarë të
14 UÇK-së ende në terren, struktura e komandimit në thelb po
15 përpiqej që të gjente mënyrën se si të realizonte
16 demobilizimin dhe demilitarizimin për të cilin angazhuar, pra,
17 ata po shikonin z. Çeku, komandantin Çeku, z. Thaçi dhe
18 persona të tjerë se çfarë mund të bënin ata brenda UÇK-së në
19 mënyrë të tillë që të respektonin premtimet e dhëna. Ata
20 gjithashtu janë përpjekur që të ndalojnë çfarë kanë parë, pra,
21 për të ndaluar dhunën që vazhdonte, por një pjesë dërrmuese,
22 një pjesë e mirë e saj organizohej në nivelin lokal, po dhe
23 nuk kishte nuk ekzistonte absolutisht asnjë strukturë
24 komanduese që ai mund të përdorte për të ndaluar dhunën.

25 PY. Pse e cenonte ose pse e dëmtonte kauzën e tyre të

1 pavarësisë dhuna që vazhdonte të ushtrohej në Kosovë?

2 PË. Sikurse kemi mësuar në takimin e parë me z. Thaçi dhe me
3 të tjerët, objektivi i tyre kryesor ishte pavarësia e Kosovës,
4 pra, krijimi i një shteti të pavarur. Dua të kthehem një hap
5 pas.

6 Vetëm disa vite përpara sesa qeveritë perëndimore ta
7 konsideronin UÇK-në si grup terrorist, pra, kishte pak kohë
8 kur ata e kishin konsideruar UÇK-në si grup terrorist, kështu
9 që u desh ca kohë që ata të shikonin Kosovën si një vend ku të
10 gjithë njerëzit mund të jetonin në paqe dhe në siguri dhe që
11 të ishin më të organizuar më të disiplinuar. Dhe mënyra ose
12 demonstrimi se si ata po kontribuonin për uljen, për
13 reduktimin, minimizimin e pasojave negative të dhunës,
14 sigurisht që kishte ndikim mbi shtetet anëtare dhe ishte
15 pozitive në vetvete për të fituar mbështetjen e NATO-s dhe të
16 BE-së. Domethënë, do ishte në -- nuk do ishte në interesin e
17 tyre që të jepej imazhi i dhunës së vazhdueshme.

18 PY. Kur ju thatë që "ata të jepnin përshtypjen që njerëzit
19 jetonin në paqe dhe në siguri dhe që të krijohej një Kosovë ku
20 të gjithë njerëzit jetonin në një situatë të tillë", një prej
21 këtyre personave që mendonte kështu a ishte Hashim Thaçi,
22 Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. A është e drejtë që ai, Hashim Thaçi, ka bërë një fjalim
25 dhe ka folur publikisht në vitin 1999 dhe ka deklaruar që i

1 duhet dhënë fund dhunës, pra, duhet që "të bëhet thirrje për
2 tolerancë dhe jo dhunë"?

3 PË. Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Baiesu, keni
9 pyetje?

10 Z. BEQIRI: [Përkthim] Po.

11 Pyetje të palës tjetër nga z. Beqiri:

12 Z. BEQIRI: [Përkthim]

13 PY. Z. Durkee, unë jam Mentor Beqiri dhe jam përfaqësues i
14 Jakup Krasniqit. Kam pak pyetje për ju sot.

15 Z. Durkee, duke iu referuar deklaratës tuaj, në
16 paragrafët 15 dhe 16 konkretisht, besoj që pajtoheni me mua që
17 situata pas lufte në Kosovë në qershor, korrik 1999 ka qenë
18 shumë kaotike, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Sikurse e përmendët sot në faqen 5 të transkriptit mijëra
21 refugjatë u kthyen në Kosovë në çështje javësh, a është e
22 saktë kjo?

23 PË. Po.

24 Z. BEQIRI: [Përkthim] A mund të paraqisni në ekran një
25 dokument me numër DHT805. DHT08520. Ju lutem kalojmë pak më

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Beqiri

Faqe 14

1 poshtë në faqe.

2 PY. Dëshmitar, ky është një raport i Organizatës së Kombeve
3 të Bashkuara për Refugjatët i qershorit të 1999-s, ju lutem,
4 lexoni pjesët që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe Maqedoninë.
5 PË. Në rregull.

6 PY. Këto janë shifra të cilat janë raportuar nga Organizata e
7 Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Këto shifra a përkojnë me
8 numrin e refugjatëve të kthyer në Kosovë pas luftës?

9 PË. Po, këto kanë qenë konstatime dhe të KFOR-it.

10 PY. Nevoja për strehim, për kujdes shëndetësor, për ushqim,
11 ka qenë një prej faktorëve kontribuues për kaosin asaj kohe,
12 apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Në paragrafin 16 të deklaratës ju thoni që:

15 "Mungesa e shërbimeve bazë dhe mungesa e funksionimit të
16 një sistemi të zbatimit të ligjit ka kontribuar për një
17 atmosferë të mungesës së ligjit që ka çuar më tej dhe ka
18 frymëzuar elementin kriminal".

19 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Tani do i kërkoj Sekretares që të paraqesë në ekran një
22 artikull që është botuar në një gazetë.

23 Z. BEQIRI: [Përkthim] Numri i dokumentit ë DJK01075.

24 PY. Z. Durkee, bëhet fjalë për një artikull gazete që është
25 botuar në datën 14 gusht 1999, në paragrafin e dytë thuhet:

1 "Ne nuk duhet të drejtojmë gishtin nga UÇK-ja. Në
2 nivelet më të larta, ata po bashkëpunojnë me ne. Por ne duhet
3 të dinë që elementë të huaj po mbërrijnë këtu nga të gjitha
4 anët e kufirit', tha Komandanti Suprem i forcave të NATO-s në
5 Evropë, në një konferencë të shkurtër për shtyp në Prishtinë
6 në Kosovë."

7 Duke parë çfarë është shkruar këtu, ju besoj që pajtoheni
8 që kishte elementë kriminalë që mbërrinin në Kosovë nga të
9 gjitha anët e kufijve, apo jo, Dëshmitar?
10 PË. Po.

11 PY. Dhe është e mundur që kjo situatë të ketë kontribuar në
12 atmosferën e mungesës së ligjit në atë kohë në Kosovë, apo jo?
13 PË. Po.

14 Z. BEQIRI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që ky
15 artikull gazete të pranohet në provë materiale. Po ashtu kjo
16 është pjesë e Mbrojtjes së Krasniqit, vlerësimi i ynë, ne
17 mendojmë që ky është një dokument i cili duhet pranuar sepse i
18 përbush kriteret për pranimin e materialeve.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
21 ka kundërshtime, dokumenti DJK01075 pranohet në prova
22 materiale.

23 Z. BEQIRI: [Përkthim] Faleminderit që iu përgjigjët
24 pyetjeve të mia. Nuk kam pyetje të tjera për ju, Dëshmitar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ZPS-ja ka

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 16

1 pyetje?

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë faleminderit,
3 të nderuar Gjykatës. Dokumenti DJK01075 do pranohet dhe
4 përkthimet përkatëse në shqip dhe në anglisht, numri i provës
5 që i caktojmë është 4D00143, klasifikimi është publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Tani e keni fjalën ju, Prokurore.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 Gjykatës.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli:

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

13 PË. Mirëmëngjes.

14 PY. Unë do prezantohem. Unë jam Silvia D'Ascoli. Jam
15 Prokurore me ZPS-në, do t'ju bëj disa pyetje në emër të
16 Prokurorisë sot. Fillimisht kisha vlerësuar që do përdorja dy
17 orë e gjysmë për t'ju bërë pyetje, megjithatë shpresoj që do
18 më duhet më pak kohë.

19 Dëshmitar, gjatë pyetjeve të Mbrojtjes dje, në paragrafin
20 5 të deklaratës tuaj, ju dhatë dëshmi lidhur me përvojën tuaj
21 profesionale, punën tuaj në Ballkan përpara sesa keni punuar
22 si këshilltar i lartë i Gjeneralit Wesley Clark, ju keni
23 punuar me Gjeneralin George Joulwan dhe e gjithë kjo ka
24 ndodhur në SACEUR përpara deri në vitin 1997, apo jo, është e
25 saktë kjo?

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 17

1 PË. Po.

2 PY. Gjatë kohës që keni punuar me Gjeneralin George Joulwan,
3 ju jeni marrë gjithashtu edhe me zyrtarë serbë, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe kontaktet tuaj a kanë qenë të vazhdueshme me zyrtarët
6 serbë edhe kur keni filluar që të punoni për Gjeneralin Clark?

7 PË. Po.

8 PY. Për shembull, siç është përshkruar gjithashtu nga
9 Gjenerali Clark në librin e vet, ju e keni shoqëruar
10 Gjeneralin Clark në takimin e tij me Milosheviqin, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Kur përshkruat përgjegjësitë tuaja si këshilltar i lartë
13 i Gjeneralit Clark dhe na thatë se ju "shihnit zhvillimet në
14 mjedisin operativ sa i takon përpjekjeve të vazhdueshme të
15 Sllobodan Milosheviqit dhe forcave të tij për të shtypur
16 rezistencën shqiptare. Këtë e keni thënë në faqen 111 të
17 transkriptit të ditës së djeshme. Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes, ju thatë që z. John Duncan
20 ka qenë pjesë e stafit tuaj, një prej këshilltarëve tuaj. A e
21 keni ndjekur dëshmitë në këtë proces gjyqësor në shtator të
22 2025?

23 PË. Dëshminë e kujt?

24 PY. Dëshminë e John Duncan.

25 PË. E di që ka dhënë dëshmi.

1 PY. Jo, po ju pyes në qoftë se e keni dëgjuar dëshminë e tij,
2 apo jo?

3 PË. Nuk kam pasur qasje drejtpërdrejt në atë kohë, por kam
4 parë një video të dëshmisë së tij më vonë.

5 PY. Në rregull. E kuptojmë. Mbase e dini ose jo që në
6 dëshminë e vet z. Duncan ka thënë që juve e njihni mirë
7 çështjet serbe, a është e saktë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Z. Duncan i ka thënë këtij Trupi Gjykues që ju të dy keni
10 ndarë çështjet e Kosovës dhe të Serbisë, pra, z. Duncan ka
11 qenë përgjegjës për çështjet e Kosovës dhe ju keni mbuluar
12 çështjet e Serbisë për shkak të ekspertizës tuaj, të përvojës
13 tuaj me çështjet serbe. A është një përshkrim i saktë ky i
14 ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet jush dhe z. Duncan,
15 Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. A do ishte e drejtë të thuhej, që sipas mendimit tuaj, z.
18 Duncan ishte personi më i informuar lidhur me shtabin e SHAPE
19 në Kosovë, shqiptarët e Kosovës, përfshirë këtu dhe UÇK-në?

20 PË. Po.

21 PY. Kjo ishte sepse në rolin tuaj në SHAPE ju e dini që John
22 Duncan kishte shpenzuar më shumë kohë me ta ndërkohë që po
23 negocionte marrëveshjen, a është kështu, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Gjatë rolit tuaj si këshilltar i Gjeneralit Clark, dhe po

1 flas për pjesën parë të vitit 1999, ju ishit i bazuar në
2 shtabin e Komandës Supreme të NATO-s në Belgjikë, apo jo?
3 PË. Po.
4 PY. Dhe nuk keni shkuar në Kosovë gjatë asaj periudhe kohore?
5 PË. Jo përpara fundit të konfliktit.

6 PY. Në seancën përgatitore qartësuat se Gjenerali Clark u
7 caktoi juve detyrën që të jeni përfaqësuesi i tij në
8 Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake dhe ju dërgoi në Kosovë për
9 këtë. Dhe kështu dëshmuat edhe dje që është shënuar në faqen
10 125 të transkriptit.

11 Tani, libri i Gjeneralit Clark "Bërja e luftës moderne",
12 referenca është faqja DHT11502, në këtë libër thuhet se
13 Gjenerali Clark ju dërgoi juve në Maqedoni që të punonit me
14 Jackson gjatë negociatave në vijim përpara arritjes së
15 Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake edhe për rrjedhojë negociatat
16 me serbët dhe kjo ka ndodhur në qershor 1999. Në *book* po ashtu
17 përmendet dhe thuhet se ju ishit linja, vija zyrtare e
18 komunikimit për Gjeneralin Clark për t'u lidhur me Gjeneralin
19 Jackson. Dhe gjithashtu në kohën kur Gjenerali Mike Jackson
20 arriti të merrte nënshkrimin e serbëve për Marrëveshjen
21 Tekniko-Ushtarake, Jackson ishte dërguar në Maqedoni për tre
22 muaj. Ju kujtohet kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Besoj se në seancën përgatitore, ju keni thënë se ishit
25 në Kumanovë për ato negociata jo në Kosovë, a është e saktë?

1 PË. E saktë.

2 PY. Në rregull. Pra, është e saktë të themi që jeni dërguar
3 nga Gjenerali Clark në Maqedoni, jo në Kosovë, siç duket që
4 keni thënë në deklaratën tuaj lidhur me ato negociata?

5 PË. I dislokuar, po, i dërguar në Kumanovë, po.

6 PY. Tani, në kontekstin e negociatave të Kumanovës, siç e
7 kuptuam nga ajo që thatë ju, ju keni punuar me Gjeneralin
8 Jackson, e saktë?

9 PË. E saktë.

10 PY. Dhe po në këtë kontekst ju keni patur tre diskutime,
11 komunikime me delegacionin serb në negociata?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe keni marrë pjesë në takime midis serbëve dhe
14 Gjeneralit Jackson?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe --

17 PË. Jo në të gjitha natyrisht, por në ato që ishin më publike
18 që ishin takimet më të mëdha.

19 PY. Dhe, në fakt, keni thënë në seancat përgatitore këtë gjë.
20 Tani, dërgimi juaj në Maqedoni, detyra juaj edhe atje tregon
21 ekspertizën tuaj, është tregues i ekspertizës tuaj për çështje
22 që kanë të bëjnë me serbët dhe Serbinë?

23 PË. E saktë.

24 PY. Dhe besoj që e keni thënë në deklaratën tuaj në
25 paragrafin 9 këtë gjë.

1 Tani do të kaloj në paragrafin 12 të deklaratës dhe, kjo
2 është për t'ju orientuar, paragrafi ku diskutohet takimi me
3 delegacionin e Kosovës në një vend jashtë Mons në Belgjikë.

4 Ju keni shpjeguar gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja se
5 ky takim është i njëjti si ai i datës 19 mars 1999, i cili
6 përmendet në artikullin e BBC-së që iu paraqit juve dhe mban
7 numrin e provës materiale 1D360.

8 Tani duke parë, po shohim listën e pjesëmarrësve që
9 renditen në këtë artikull, ju thoni se personat që njihni aty
10 ishin z. Thaçi dhe z. Krasniqi. Besoj se sot thatë që ka qenë
11 takimi i parë që keni patur me ta. Pra, kjo ishte hera e parë
12 që ju kishit një takim të drejtpërdrejtë apo kontakt të
13 drejtpërdrejtë me z. Thaçi?

14 PË. Po.

15 PY. Në paragrafin 13 të deklaratës tuaj, prova 1D428, keni
16 përshkruar përshtypjet tuaja që kishit për z. Thaçi që keni
17 patur nga ai takimi i parë me të, pra, në takimin mes tij,
18 Gjeneralin Clark, ju dhe delegacioni i Kosovës. Ju shpjeguat
19 gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja dhe këto përshtypje dhe
20 ku bazoheshin këto, që të jem e qartë. Nuk do t'i kthehem
21 kësaj çështjeje. Por dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me atë që
22 dinit apo nuk dinit për z. Thaçi në atë kohë.

23 Tani, përpara Rambujesë a kishit dëgjuar për z. Thaçi?

24 PË. Po, besoj që ai ishte identifikuar në raportime publike
25 si udhëheqësi i të ashtuquajturës drejtori politike e UÇK-së.

1 PY. Dhe kaq kishit dëgjuar për të?

2 PË. Po.

3 PY. Në atë kohë e dinit kush ishin themeluesit e UÇK-së?

4 PË. Nuk mendoj që në atëkohë kishim njohuri të shumta apo
5 informacione lidhur me zhvillimin e UÇK-së dhe kjo deri gjatë
6 vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999.

7 PY. Pra, nuk e dinit nëse z. Thaçi ishte themeluesi i UÇK-së?

8 PË. Nuk e dija.

9 PY. E dinit çfarë roli mbante z. Thaçi apo çfarë roli mori në
10 organizimin e UÇK-së pas kohës kur UÇK-ja po zhvillohej?

11 PË. Nuk e di.

12 PY. A e dini nëse z. Thaçi ishte një prej anëtarëve të parë
13 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

14 PË. Nuk mendoj që në kohën kur jemi takuar me z. Thaçi në
15 Mons, ai, nuk besoj, që ai ishte identifikuar si një person
16 apo udhëheqës apo komandant i Shtabit të Përgjithshëm. Ai
17 ishte identifikuar si një udhëheqës, dhe po citoj i
18 "Drejtorisë Politike të UÇK-së", që do të ishte diçka e ndarë
19 natyrisht nga Shtabi i Përgjithshëm.

20 PY. E kuptoj këtë. Pra, ky ishte informacioni që kishit ju në
21 atë kohë?

22 PË. Po.

23 PY. Në rregull. A dinit ndonjë gjë për përfshirjen e z. Thaçi
24 apo jo në furnizimin me armë, për shembull?

25 PË. Nuk kam ndonjë njohuri konkrete lidhur me këtë.

1 PY. E dinit nëse ai ishte i pranishëm gjatë veprimeve

2 ushtarake të UÇK-së? E kam fjalën në Bardhin e Madh, në

3 Bellagevc, në korrik të 1998?

4 PË. Nuk kam njohuri konkrete se çfarë mund të ketë bërë ai në

5 1998.

6 PY. Tani do kaloj tek paragrafët 13, 14, 18 ku juve dhatë

7 mendimet, pikëpamjet tuaja lidhur me UÇK-në dhe mungesën e

8 zinxhirit komandues. E përsëritët këtë gjë edhe sot në

9 mëngjes.

10 Dhe në transkriptin provizor të djeshëm gjatë marrjes në

11 pyetje nga Mbrojtja, ju thatë se duke iu referuar pranverës së

12 1999, thatë se nuk kishit një informacion shumë të mirë dhe

13 nuk kishte vlerësim të mirë sa i takon kapaciteteve ushtarake

14 të UÇK-së sepse për shkak të informacionit të kufizuar që ju

15 merrnit. Ju e dinit që ata kishin luftëtarë në terren, por nuk

16 e dinit sesa shumë, ku ishin stacionet të vendosur, cilat

17 ishin kapacitetet dhe aftësitë e tyre, këtë nuk e dinit me

18 saktësi.

19 Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me faktin nëse ju

20 dinit apo nuk dinit për gjërat që ju dini apo nuk dini për

21 UÇK-në në atë kohë. Për shembull, a e dini përmbajtjen e

22 rregulloreve të UÇK-së?

23 PË. Mund ta përsërisni pyetjen.

24 PY. A jeni në dijeni, a njihni përmbajtjen e ndonjë prej

25 rregulloreve të UÇK-së?

1 PË. Jo.

2 PY. A e dinit ju kush ishin anëtarët apo ndonjë prej
3 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? E kemi
4 trajtuar këtë pikë lidhur me z. Thaçi, por pyetja ime është
5 pak më e gjerë.

6 PË. Dhe e keni fjalën për pranverën e 1999?

7 PY. Po flas për njohuritë që kishit ju në atë kohë.

8 PË. Nuk mendoj që ne kishim ndonjë informacion konkret në
9 dispozicion lidhur me përbërjen dhe anëtarësinë e të
10 ashtuquajturit Shtab të Përgjithshëm.

11 PY. Kishit qasje, keni parë apo marrë ndonjë urdhër të UÇK-
12 së, qoftë të nivelit qendror apo në nivel të Shtabit të
13 Përgjithshëm apo në nivel të zonës?

14 PË. Ne ishim në dijeni të deklaratave publike që ishin bërë
15 nga njerëz në emër të UÇK-së që përshkruanin atë që ata
16 konsideronin si urdhëresa apo komunikata, po.

17 PY. Dhe kaq ishin njohuritë apo ajo që kishit ju në atë kohë
18 e keni fjalën?

19 PË. Në atë kohë po.

20 PY. Pra, "deklarata publike", thjesht po lexoj "deklarata
21 publike të bëra nga njerëz në emër të UÇK-së ku përshkruan
22 ... ato që ata i konsideronin si urdhëresa apo komunikata."

23 PË. Po. Sepse, në qoftë se mund ta elaboroj pak, qeveritë
24 perëndimore po zhvillonin ngadalë rrjetin e tyre të
25 informacionit në atë pjesë të ish-Jugosllavisë, pra, shumë

- 1 vëmendje ishte kushtuar konfliktit në Bosnje dhe këtij për të
2 zhvilluar burimet e informacionit lidhur me atë që po ndodhte
3 dhe vetë në Serbi. Pra, shumë vëmendje ishte kushtuar -- jo
4 shumë vëmendje, nuk ishte kushtuar shumë vëmendje zonës
5 konkrete të Kosovës. Ishte një proces në zhvillim e sipër.
6 PY. E kuptoj këtë. Dhe nuk kishit qasje në urdhra konkretë të
7 UÇK-së mesa kuptoj?
8 PË. Kjo është e saktë.
9 PY. Cilat ishin -- po lidhur me raportet që i dërgoheshin
10 Shtabit të Përgjithshëm, pra, raportet e UÇK-së që i
11 dërgoheshin Shtabit të Përgjithshëm?
12 PË. Në qoftë se a mund t'i shihnim ne. Më duhet t'i qartësoj
13 raportet nga kush?
14 PY. Raportet e brendshme të UÇK-së, pra, raportet nga zonat.
15 Ju përmendët që ishit në dijeni të zonave operationale të UÇK-
16 së. Komandanti i zonave?
17 PY. Nuk më kujtohet ndonjë gjë që është identifikuar si
18 raport i dërguar nga komandantët e zonave operative tek dikush
19 apo diçka që mund të quhej Shtabi i Përgjithshëm.
20 PY. Ishit në dijeni të inspektimeve apo vizitave që bënte
21 Shtabi i Përgjithshëm apo pjesëtarët, anëtarët e Shtabit të
22 Përgjithshëm në zonat operative të UÇK-së?
23 PË. Jo.
24 PY. Nuk ishit në dijeni për këtë?
25 PË. Jo.

1 PY. A ishit në dijeni për këtë?

2 PË. Jo.

3 PY. A ishit në dijeni për mënyrën se si zonat operative të
4 UÇK-së ishin të organizuara brenda në vetvete?

5 PË. Ne kishim vetëm njohuri të kufizuara dhe të përgjithshme
6 lidhur me atë që po ndodhte në nivelin e zonave operative
7 sepse secila prej tyre ishte zhvilluar në mënyrë individuale
8 bazuar në interesat dhe aktivitete dhe kapacitete të njerëzve
9 që jetojnë në ato zona. Ata ishin krijuar, formuar fillimisht
10 si roje të armatosura të fshatit dhe pastaj më vonë ishin
11 zhvilluar në forca të organizuara luftarake. Po në nivel të
12 zonës nuk më kujtohet informacion pra, nga zonat operacionale
13 ose për luftëtarë që të jenë transferuar nga një zonë
14 operative në një zonë tjetër për ndonjë operacion të ndryshëm
15 në zona të ndryshme. Ata ishin të bazuar në nivel lokal dhe
16 vendor.

17 PY. Pra, ju po rithoni atë që faktin që informacioni në atë
18 kohë ishte i kufizuar?

19 PË. Po.

20 PY. Nëse mund të bëj një përmbledhje tani dhe do të kaloj tek
21 vërejtjet, tek komentet e bëra lidhur me verën e 1999-s. Në
22 shënimin përgatitor, që është tani në provë si 1D427 dhe në
23 paragrafin 15, si dhe në marrjen në pyetje të djeshme, ju
24 sqaruat se deklarata juaj, pra, në deklaratën tuaj se kishit
25 mundësi të plota, të bollshme për të vërejtur realitetin në

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 27

1 terren në Kosovë, që është deklaratë që keni bërë në
2 paragrafin 15 të deklaratës dhe kjo bazohej në përafërsisht
3 katër vizitat që keni bërë në Kosovë në verën e 1999. Dhe
4 sqaruat, shpjeguat dhe këtë gjë në transkript, kjo gjendet në
5 faqen 131 që në tërësi këto vizita kanë qenë gjashtë apo
6 shtatë ditë.

7 PË. Po.

8 PY. Ju kujtohet kjo? Tani mesa kuptoj nga shënimi përgatitor
9 dhe marrja në pyetje dhe, se të paktën prej këtyre vizitave
10 nga katër vizitat që keni bërë në Kosovë, keni shoqëruar
11 Gjeneralin Clark?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe besoni që këto kanë qenë më 1 dhe 13 gusht 1999 dhe
14 për 13 gushtin jeni 100 për qind i sigurtë?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe dua të përqendrohem tek këto dy vizita.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë, të nderuar Gjykatës,
18 do kërkoja të kalojmë në seancë private për arsye të imponuara
19 nga siguruesi i informacionit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë
21 private, faleminderit.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 28

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 30

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 31

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 32

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 33

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 34

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 35

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Seanca ndërpritet për dhjetë minuta.

18 --- Seanca ndërpritet në orën 09.57

19 --- Seanca rifillon në orën 10.11

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

21 sillni dëshmitarin.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurorja do

24 të vijojë me pyetjet e veta.

25 Vazhdoni znj. D'Ascoli.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Z. Dëshmitar, do të vazhdojmë më tej. Dua të flasim tani
3 për konstatimet tuaja gjatë këtyre katër vizitave në Kosovë, e
4 në veçanti për deklaratën që keni dhënë - në paragrafin 16 dhe
5 17 - ku flisni për faktin që dhuna dhe krimet që keni parë
6 ishin si rezultat i hakmarrjes, ishin reagime shoqërore dhe
7 nuk ishin të organizuara nga lart.

8 Si pyetje paraprake dëshiroj t'ju pyes, e keni lexuar
9 aktakuzën e kësaj çështje gjyqësore?

10 PË. Për cilin dokument e keni fjalën?

11 PY. Jo, pyetja ime është kjo: A e keni lexuar aktakuzën në
12 çështjen kundër z. Thaçi dhe të tjerëve?

13 PË. Jo, nuk e kam lexuar.

14 PY. Atëherë a kam të drejtë unë kur them se ju nuk e dini për
15 çfarë krimesh akuzohen këta persona?

16 PË. Jo, nuk e di.

17 PY. Tani dua të fokusohemi jo tek dhuna hakmarrëse, jo te
18 shpagimi, jo tek krimet e përditshme, po për krimet që janë
19 kryer kundër personave që janë mbajtur në qendrat e ndalimit
20 të UÇK-së. Ju duhet ta dini, duke mbajtur parasysh pozitën që
21 keni pasur, se në '98-n dhe '99-n ka pasur disa krime që dukej
22 sikur ishin të organizuara prej UÇK-së, apo jo?

23 PË. Kam dëgjuar -- kam dijeni për raporte të tilla, po.

24 PY. A jeni në dijeni për akuzat për krimet që janë kryer
25 kundër personave të mbajtur në qendra ndalimi që

1 administroheshin nga UÇK-ja në '98-n dhe '99-n?

2 PË. Kam dëgjuar raportime të këtij lloji.

3 PY. Pra, krimet e UÇK-së në fakt janë raportuar dhe në lajme,
4 dhe dua të diskutojmë bashkë disa raste. Në veçanti, a ju
5 kujtohen raporte kur UÇK-ja ka marrë kontrollin në qytetin e
6 Rahovecit në korrik '98?

7 PË. Jo.

8 PY. Pra, nuk ju kujtohen raporte për faktin që UÇK-ja ka
9 ndaluar rreth 85 serbë në këtë rast?

10 PË. Jo.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran
12 provën materiale P380 dhe të shohim në PDF faqen 6 të
13 materialit që ka numrin ERN 0364869. Pra, 364870, gjithashtu.

14 PY. Dëshmitar, për kontekst ky është një raport i *Human*
15 *Rights Watch* data 1 tetor 1998. Do t'ju lexoj nga pjesa ku
16 thuhet "Rrëmbimet në Rahovec". Ju mund të na ndiqni në ekran.

17 "Më 19 korrik, UÇK-ja filloi sulmin e parë madhor në një
18 qytet të madh, Rahovecin. Mendohet se rreth 85 serbë janë
19 mbajtur të ndaluar nga UÇK-ja ndonëse 35 syresh më pas u
20 liruan. Që prej gushtit 1998, të paktën 40 persona nuk dihet
21 ende ku janë."

22 Vijon më tej, por fillimisht unë dua të fokusohemi në
23 disa pika lidhur me këtë paragraf.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Por të shkojmë një herë në
25 faqen tjetër. Paragrafi i dytë thotë, fati --

1 PY. "Fati i rreth 40 personave të tjerë që janë marrë nga
2 zona e Rahovecit është ende i paditur".

3 Dhe në fund të të njëjtit paragraf thuhet:

4 "Ekzistojnë raporte se janë dhe 17 persona të tjerë që
5 janë rrëmbyer nga UÇK-ja nga fshati Retimje afër Rahovecit."

6 Ju ndihmon kjo, ju ndihmon gjë kjo nëse keni pasur dijeni
7 apo jo?

8 PË. Nuk më kujtohet ky raport konkret, jo.

9 PY. E kuptoj.

10 PY. *New York* --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 D'Ascoli, një çast.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dua të sqaroj diçka, cili është
14 qëllimi i këtyre pyetjeve, është në kuadër të rregullës 143
15 që:

16 "Kundërpyetjet duhet të kufizohen vetëm në pyetjet që ka
17 bërë pala thirrëse edhe në besueshmërinë e dëshmitarit".

18 Pra, dëshmitari është thirrur për të dëshmuar për
19 ngjarjet e '99-s, ne nuk bëmë asnjë pyetje nga ana jonë për
20 ato që kanë ndodhur në 1998-n. Unë e kuptoj që ju keni të
21 drejtë të nxirrni prova të reja që janë në favor të
22 argumenteve tuaja, por nuk janë pjesë e fushëveprimit të
23 pyetjeve tona. Por përpiqem të kujtoj për çfarë i bëni këto
24 pyetje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

1 [Përkthim] Kush është kundërshtimi?

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk kam kundërshtim dua të
3 kuptoj qëllimin e pyetjeve sepse mendoj që nuk janë pjesë e
4 fushëveprimit të pyetjeve tona.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E para për
6 besueshmërinë edhe është në favorin e argumenteve të tyre. Të
7 gjitha këto materiale janë diskutuar, qofshin këto për '98-n,
8 '99-n sepse ne duam të kuptojmë sa njohuri ka ky zotëri lidhur
9 me situatën dhe është një dëshmi relevante kështu që do të
10 vijojmë.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Pra, z. Dëshmitar, siç po ju thoja këto ngjarje janë
13 raportuar edhe nga *New Your Times* në një artikull të 13
14 gushtit 1998. Mund të shikojmë dokumentin nëse dëshironi.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ka marrë numrin e provës
16 materiale 4153.

17 PY. Edhe Departamenti i Shtetit Amerikan në raportet e veta
18 për drejtat e njeriut për Serbinë dhe Malin e Zi ka raportuar
19 për krimet në Kosovë. Duhet të keni pasur dijeni lidhur me
20 këto.

21 PË. Përgjithësisht, po.

22 PY. Për shembull, a ju kujtohet apo keni pasur dijeni që kanë
23 ekzistuar raporte që UÇK-ja shënjestronte ata persona që
24 perceptoheshin si bashkëpunëtorë dhe civilë?

25 PË. Nuk më kujtohet, por kam dëgjuar gjëra të ngjashme

1 asokohe, po.

2 PY. Në rregull.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shohim në ekran provën 4502.

4 PY. Ky është një raport i Departamentit të Shtetit Amerikan
5 lidhur me praktikat në Serbi dhe Malin e Zi, praktikat për të
6 drejtat e njeriut, domethënë. Është një raport që në fakt ka
7 dalë në shkurt 1999. Mund ta shihni në faqen e parë datën.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen 2 të
9 raportit.

10 PY. Dua të shihni paragrafin para titullit "Respektimi i të
11 drejtave të njeriut". Ku thuhet:

12 "Elementet e ... (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ...) po
13 ashtu kanë qenë përgjegjës për shpërdorime. Kanë kryer vrasje,
14 janë përgjegjës për zhdukjet, kanë rrëmbyer, kanë mbajtur të
15 ndaluar policë serbë si dhe civilë serbë dhe shqiptarë (ata që
16 dyshoheshin se ishin besnikë ndaj qeverisë serbe) dhe në disa
17 raste të pakta janë 'gjykuar' të dyshuarit pa proces të
18 rregullt ligjor. Ka raporte të besueshme që ka pasur dhe raste
19 torturash prej UÇK-së."

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 5 të të
21 njëjtë raport. Po lexoj paragrafin e parafundit, ju lutem. Ta
22 shohim paragrafin e fundit.

23 PY. Në mes të paragrafit thuhet:

24 "Në tetor UÇK-ja, pra, tetor '98, UÇK-ja ndaloi 13
25 politikanë shqiptarë, përfshirë deputetë të Parlamentit të

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 41

1 Kosovës dhe i mbajti të ndaluar në Qirez për dy ditë. Forcat e
2 UÇK-së raportohet se kanë torturuar në mënyrë të vazhdueshme 6
3 prej 13 të ndaluarve të cilët sipas tyre ishin shumë afër me
4 qeverinë serbe.”

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe faqja 8 e të njëjtit raport
6 SPOE00397695. Po ju lexoj paragrafin e fundit të kësaj faqe.
7 PY. “Luftëtarët separatistë kanë ndaluar gazetarë serbë dhe
8 kanë mbajtur disa peng dhe ka pasur raste të besueshme kur
9 mendohet se bashkëpunëtorët janë vrarë. Janë kërcënuar disa
10 shqiptarë që punonin në institucione” --
11 PË. Nuk e kuptoj ku jeni. Nuk po e gjejmë, nuk po e gjejmë,
12 nuk po e gjejmë në faqe.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po filluat të
14 lexoni një paragraf që nuk është këtu. Ju lutem lexojeni dhe
15 një herë.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Fillova --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, e
18 keni gjetur në tekst ku jemi?

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo. Në fund apo në fillim? Këtu ku
20 thuhet “Luftëtarët separatistë ...”?

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Unë lexova fjalinë e fundit që
22 fillon po ashtu me “Luftëtarët separatistë”.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të jeni
24 pak më të kujdesshëm kur jepni, na orientoni ku duhet të
25 lexojmë në faqe.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E shoh, po.

2 PY. Lexuam pra, disa pjesë të këtij raporti. A ju kujtohet ky
3 lloj informacioni? A ju është raportuar në atë kohë? Keni
4 pasur dijeni?

5 PË. Kam pasur dijeni se kishte gjithnjë e më shumë raporte se
6 po përshkallëzohej dhuna në rajone të ndryshme. Por më duhet
7 të shtoj se nga pikëpamja e SHAPE, ne nuk ishim të gatshëm për
8 operacione ushtarake në atë zonë, kështu që krahasuar me atë
9 që ndodhi në Bosnje ne kishim më të kufizuar vëmendjen për
10 Kosovën. Në ato momente Kosova nuk ishte në radarin tonë si
11 një vend ku mund të kryenin mision të ngjashëm me atë të
12 Bosnjës.

13 PY. Në rregull.

14 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
15 SPOE00397705 deri në 00397756. Dhe fillojmë me faqen e parë.

16 PY. Kjo është raport tjetër i Departamentit të Shtetit
17 Amerikan për Serbinë dhe Malin e Zi i botuar në vitin 2000 por
18 që ka lidhje me vitin 1999.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në faqen 24
20 të PDF që ka ERN SPOE00397728.

21 PY. Dëshmitar, e pamë në faqen e parë që jemi në
22 përmbledhjen, pjesën e përmbledhjes për torturën dhe trajtime
23 të tjera çnjerëzore. Këtë jua thashë për kontekst se cila
24 është pjesa përkatëse e dokumentit. Do të lexoj një paragraf
25 që është nga fundi i faqes.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë më poshtë. Është
2 paragrafi i parafundit, ku thuhet: "Sipas *Human Rights Watch*,
3 pas" -- jo, më falni, është pak më poshtë. Është paragrafi i
4 tretë nga fundi:

5 "Sipas *Human Rights Watch*, pas tërheqjes së forcave serbe
6 ..."

7 Po më ndiqni, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Në rregull. Pra edhe një herë:

10 "Pas tërheqjes së forcave serbe anëtarë të UÇK-së kanë
11 torturuar serbë etnikë, shqiptarë etnikë që dyshohej se
12 bashkëpunonin me autoritet serbe dhe romët, përfshirë rrahjen
13 e serbëve në moshë të thyer. KFOR-i gjeti një dhomë torture në
14 një fjetore të UÇK-së në fund të gushtit ku kishte armë,
15 municione, eksplozivë edhe mina."

16 PË. Po?

17 PY. Ju kujtohet?

18 PË. Jo.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 26 të PDF-së,
20 me numër SPOE00397730.

21 PY. Sërish për ta kuptuar se ku do të lexojmë, do lexojmë
22 tani tek pjesa ku diskutohen ndalimet dhe arrestimet
23 arbitrare. Unë do t'ju lexoj paragrafin e dytë.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë, ju
25 lutem.

1 PY. Mund ta shihni paragrafin. Është paragrafi i dytë nga
2 lartë ku thuhet:

3 "Ekzistonin raportime se kishin ndodhur rrëmbime prej
4 UÇK-së dhe se ishin mbajtur të ndaluar persona gjatë vitit,
5 gazetarë, kundërshtarë politikë edhe serbë. Më 18 qershor
6 forcat e KFOR-it lëshuan, liruan - më falni - rreth 15 persona
7 që mbaheshin të ndaluar në një stacion policie në Prizren.
8 Viktimat raportuan se anëtarë të UÇK-së i kishin rrahur ... Në
9 fillim të gushtit, zyra lokale e LDK-së në Gjilan po ashtu u
10 bastis dhe disa prej përfaqësuesve u mbajtën të ndaluar dhe u
11 kërcënuan."

12 E njëjta pyetje, Dëshmitar, keni pasur dijeni për krime
13 të tilla prej UÇK-së asokohe?

14 PË. Nuk më kujtohet ky raport konkret, por mbaj mend që KFOR-
15 i ka raportuar përmes kanaleve të rregullta të informimit se
16 kishte incidente që UÇK-ja nuk po respektonte kushtet dhe se
17 kishte akte dhune ndaj personave të ndryshëm.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, doja të
20 pranoheshin fagen që përdora me dëshmitarin. Më konkretisht
21 unë do të doja të pranohej faqja SPOE00397705, që është faqja
22 e parë, më pas SPOE00397728 edhe faqja që përfundon 7730. Këto
23 ishin faqet që përdora. Dokumentet mund të jenë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, kundërshtojmë. Dëshmitari
2 tha që nuk i ka parë asnjëherë këto raporte, nuk i kujtohet
3 asnjë prej këtyre ngjarjeve. Asnjë prej incidenteve që
4 parashtroi Prokurorja dhe mesa kuptoj unë dëshmitari nuk është
5 as i qartë në përgjigjen e fundit. Si fillim ky raport është i
6 '98-s apo i '99-s?

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Raporti është botuar në vitin
8 2000 por është për vitin 1999.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pra incidentet janë të vitit
10 1999?

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

12 ZNJ. TAVAVOLI: [Përkthim] Pra, i qëndroj të njëjtit
13 kundërshtim. Raportin s'e ka parë asnjëherë, nuk ka dijeni për
14 incidentet që raportohen në të. Edhe nuk mendoj se ky është
15 dëshmitari për të pranuar këto dokumente.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Mbështesim dhe ne të njëjtin
17 kundërshtim. Kjo është dëshmi e rëndësishme. Prokuroria ka
18 pasur shumë mundësi që këto raporte t'i pranonte përmes
19 dëshmitarëve të tjerë.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Këto nuk janë akuza të reja. Ne
21 kemi dëshmi që konfirmojnë të njëjtat incidente në fakt, të
22 cilët do t'i trajtoj me dëshmitarin dhe nuk është çështja a ka
23 apo nuk ka njohuri dëshmitari për këtë raport konkret, por
24 lidhet me dëshminë e tij sepse ai është një person që po jep
25 dëshmi për njohuri që ka ai për krimet nga UÇK-ja, veçanërisht

1 në 1999. Pra, sipas ZPS-së ky është një dokument relevant.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
3 SPOE00397705-397728 dhe 397730 pranohen sepse janë në
4 përputhje me rregullën 138. Janë relevante. Dhe janë materiale
5 që i kemi parë dhe më përpara, thjesht Prokurorja i ka kërkuar
6 dëshmitarit të komentojë lidhur me to.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto tre
8 faqe do të marrin numrin e provës P04511 dhe klasifikimi
9 publik besoj. Faleminderit.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Do të vazhdoj.
11 PY. Dëshmitar, incidentet në Prizren në gjysmën e gushtit të
12 '99-s për të cilët sapo lexuam, incidenti, në njëjës, ky ka
13 qenë një incident ku forcat e KFOR-it gjerman liruan 15 të
14 burgosur që u gjendën në një stacion policie që dikur ishte i
15 Serbisë dhe që e kishte marrë në kontroll UÇK-ja, dhe kjo ka
16 qenë e raportuar si tek *New York Times* me numër prove P1188,
17 por dhe tek CNN me numër P41850. Do të nxjerr një prej këtyre
18 artikujve nëse ju ndihmon me kujtesën.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem vendosim atëherë në
20 ekran provën P4185.

21 PY. Ky është një raport në media nga CNN në 19 qershor.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 të
23 dokumentit 013439. Ju lutem të shkojmë më poshtë.

24 PY. Dëshmitar, do të lexoj këtë pjesën ku thuhet "KFOR-i
25 lëshon, liron disa prej personave që mbaheshin nga UÇK-ja".

1 Është paragrafi i dytë poshtë fotografisë. Do të lexoj si në
2 vijim:

3 "Të premtën forcat e KFOR-it gjerman hynë në një ish-
4 stacion policie në Prizren që e kishte marrë në kontroll
5 Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe liruan 15 të burgosur që
6 dukshëm ishin rrahur nga personat që i kishin mbajtur ata të
7 ndaluar. Një i moshuar u gjet i vdekur i prangosur në një
8 karrige."

9 Nuk po e lexoj të gjithë artikullin sepse diskutohet për
10 të njëjtin incident që është raportuar edhe nga Departamenti i
11 Shtetit në raportin përkatës.

12 Pra, tani që e patë këtë artikull, a ju ndihmon kjo me
13 kujtesën, sidomos me këtë incident konkret për krimet që janë
14 kryer ndaj personave që janë mbajtur në qendra ndalimi që
15 administroheshin nga UÇK-ja?

16 PË. Nuk më kujtohet ky raport konkret që ka ardhur përmes
17 kanaleve të NATO-s nga KFOR-i. Mendoj se do të ishte raportuar
18 në këto kanale ky rast.

19 PY. Në rregull. Do të vijoj më tej.

20 Do të shohim tani paragrafin 18 të deklaratës tuaj ku
21 flisni për KFOR-in dhe për Gjeneralin Jackson. Në këtë
22 paragraf thoni se nëse Gjenerali Jackson besonte se udhëheqja
23 e UÇK-së ishte përgjegjëse për valën e dhunës dhe krimeve në
24 verën e '98-s dhe '99-s do t'i kishte ballafaquar për këto
25 gjëra.

1 Ju keni dijeni për marrëveshjen që u nënshkrua, është
2 pranuar si provë tani P1444 -- pra marrëveshja për
3 demilitarizimin që është nënshkruar mes UÇK-së dhe Gjeneralit
4 Jackson në 21 qershor 1999.

5 Ju nuk keni qenë i pranishëm kur është hartuar dhe kur
6 është negociuar kjo marrëveshje në Kosovën, apo jo,
7 marrëveshja për demilitarizimin?

8 PË. Jo.

9 PY. Ka qenë z. Duncan, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Ne dhe e dimë që autoritet që do të trajtonin
12 mosrespektimin e marrëveshjes ishte me KFOR-in, kompetencat i
13 kishte KFOR-i apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe veçanërisht këtë e kishte përgjegjësi Gjenerali
16 Jackson, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. E pranoni që Gjenerali Jackson ishte pikërisht personi i
19 duhur për të evidentuar mosrespektimin e marrëveshjes prej
20 UÇK-së edhe do t'i raportonte të gjitha rastet e
21 mosrespektimit të marrëveshjes?

22 PË. Gjenerali Jackson ka qenë shumë kompetent dhe ka qenë
23 person i kualifikuar për këtë.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës do të doja
25 të kalonim në seancë private se do të duhet të përdor

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 49

1 dokumente që janë të kufizuara prej rregullës 107 nga ofruesi
2 i informacionit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë
4 seancë private, ju lutem.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 jemi në seancë publike.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do vazhdoj
8 më tej me pyetjet.

9 Do i lutesha Sekretares të paraqesë në ekran provën P755.
10 PY. Dëshmitar, dokumenti që do shikojmë në ekran është një
11 dokument i UNMIK-ut, është një procesverbal i takimit midis
12 Bernard Kouchner dhe Gjeneralit Jackson, Hashim Thaçit, dhe
13 Agim Çekut me datë 27 korrik 1999. Ky është një kabllogram, a
14 është një dokument ky që e keni parë më herët, Dëshmitar?

15 PË. Po, e kam parë këtë dokument më herët.

16 PY. Të kalojmë tek faqja SITF001727248. Në paragrafin që ka
17 titullin "Forcat paramilitare", thuhet që arsyeja e shkëmbimit
18 në këtë fage ndërmjet Gjeneralit Jackson dhe Hashim Thaçit, në
19 veçanti në paragrafin d), sipas këtij paragrafi thuhet se
20 Gjenerali Jackson ishte i shqetësuar lidhur me elementët e
21 policisë ushtarake që visheshin me uniforma të zeza. Pra, më
22 tej thuhet që:

23 "Ata nuk kishin kompetencë që të bënin arrestime apo që
24 të bënin kidnapime dhe që besimi i UÇK-së po zbehej, ndërkohë
25 që përgjigja e Thaçit ishte evazive."

1 A keni qenë në dijeni të kësaj, Dëshmitar?

2 PË. Jo.

3 PY. A e dini që Gjenerali Jackson e ka ngritur këtë çështje
4 me Hashim Thaçin?

5 PË. Unë di që Gjenerali Jackson në mënyrë të përsëritur ka
6 ngritur rastet e shkeljeve që viheshin re, e kam fjalën këtu
7 për shkeljet e marrëveshjes dhe di që ka diskutuar me z. Thaçi
8 dhe z. Çeku për të ushtruar ndikimin e tyre për sjelljen e
9 komandantëve të zonave operative të cilët kishin autonomi të
10 konsiderueshme dhe shpesh vepronin me kokën e vet.

11 PY. Në rregull.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë në fushën
13 e fundit, në temën e fundit.

14 PY. Dëshmitar, në pyetjet që ju bëri Mbrojtja ju bëri një
15 pyetje që kishte të bënte me komentimin e fletores zyrtare të
16 Republikës Federale të Jugosllavisë që tani është pranuar në
17 prova si provë me numër 1D429. Dhe gjithashtu ju folët lidhur
18 me tërheqjen e forcave serbe nga Kosova. A keni pasur dijeni
19 që pas qershorit të '99-s kur forcat serbe duhej që të
20 largoheshin nga Kosova, vazhdoi që të kishte një lloj pranie
21 të caktuar të paramilitarëve serbë pavarësisht tërheqjes së
22 tyre?

23 PË. Po.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani për
25 shkak të konfidencialitetit të dokumenteve që do diskutoj dua

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 53

1 që të kalojmë në seancë private.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
3 në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 54

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 55

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 jemi në seancë publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
14 Mund të vazhdoni Prokurore.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

16 PY. Do të vazhdoj me të njëjtën temë.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoj
18 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin 1D00257. Ekziston
19 edhe një përkthim në shqip për këtë dokument.

20 PY. Dëshmitar, dokumenti që do shikoni tani në ekran është
21 një deklaratë politike e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës e
22 bërë nga Hashim Thaçi. Mund të shikojmë në faqen e dytë
23 nënshkrimet. Besoj që e patë, apo jo, Dëshmitar, që është një
24 deklaratë që është nënshkruar nga Hashim Thaçi. Dëshiroj t'ju
25 tërheq vëmendjen tek faqja 1, tek faqja që keni në ekran.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në veçanti paragrafin 3, që
2 është në mes të faqe, ndoshta do të ishte më mirë që ta
3 zmadhojmë për ta bërë më të qartë leximin për dëshmitarin.
4 PY. Do t'jua lexoj këtë paragraf, Dëshmitar.

5 "Pavarësisht tërheqjes së forcave serbe dhe jugosllave
6 nga Kosova, një numër i konsiderueshëm i forcave paramilitare
7 serbe vazhdojnë të qëndrojnë në Kosovë që janë të maskuar si
8 bujq edhe si civilë. Dhe shërbimi sekret serb është ende i
9 pranishëm dhe aktiv në Kosovë. KFOR-i duhet që të marrë të
10 gjithë masat e nevojshme për të eliminuar këto forca sekrete
11 dhe për të çarmatosur civilët. Bashkëpunim në këtë aspekt me
12 Qeverinë e Përkohshme të Kosovë dhe me Shtabin e Përgjithshëm
13 e UÇK-së do të kthente normalitetin në Kosovë më shpejt.".

14 Dëshmitar, a keni qenë në dijeni të faktit që edhe Hashim
15 Thaçi e ka ngritur çështjen e paramilitarëve serbë që
16 vazhdonin të ishin aktivë në Kosovë edhe gjatë asaj periudhe?
17 PË. Ky ishte një shqetësim që e dëgjonim vazhdimisht, e kemi
18 dëgjuar në vazhdimësi në SHAPE dhe ishim në dijeni të faktit
19 që kishte grupe paramilitare që ishin aktivë në Kosovë dhe që
20 kishte informantë dhe bashkëpunues të cilët gjithashtu jepnin
21 informacione të brendshme.

22 PY. A ishit në dijeni që në fund të gushtit të '99-s
23 tensionet ishin përshkallëzuar deri në atë pikë sa që Serbia
24 raportoi të ishte e përgatitur për të qenë sërish e pranishme
25 për një rimësymje tjetër.

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

Faqe 57

1 PË. Po.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kërkoj që dokumenti P2535 të
3 hiqet nga ekrani.

4 PY. Ajo çfarë diskutuam në fakt është raportuar dhe në lajme,
5 dhe për këtë arsye do të dua që të shikojmë ca dokumente të
6 tjera.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë i kërkoj Sekretares që
8 të paraqesë në ekran dokumentin SITF00194870.

9 PY. Këtu shohim një dokument. Është një raport, jepet një
10 përmbledhje e detajuar e ngjarjeve në ish-republikën
11 Jugosllave në vitin 1999. Në fund të verës së '99-s. atëherë
12 do të lexoj nga paragrafi 6.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mbase do ishte mirë ta
14 zmadhojmë pak që ta lexojë dëshmitari.

15 PY. Në paragrafin 6 thuhet si më poshtë:

16 "The Independent raporton se trupat serbe po grumbullohen
17 në kufi dhe janë të gatshme për ta pushtuar sërish Kosovën 'në
18 çdo moment', tha dje një gjeneral i Armatës Jugosllave.

19 [Gjenerali] Radovan Lazareviq, komandant i korpusit të
20 Prishtinës në Armatën Jugosllave."

21 Vazhdojmë tek faqja tjetër.

22 "Ai i ka thënë gazetës *Nedeljni Telegraf* se Beogradi do
23 të fusë trupat e tij nëse bashkësia ndërkombëtare nuk
24 respekton kushtet e marrëveshjes me të cilën i është dhënë
25 fund konfliktit mbi këtë krahinë. 'Nëse bashkësia nuk pranon

1 të zbatojë çfarë është rënë dakord, do të na duhet të përdorim
2 forcën për të rimarrë territorin tonë', tha ai."

3 E njëjta gjë raportohet edhe në faqen 4, paragrafi 15, i
4 të njëjtit raporti. Pra, ky është seksioni i cili ka të bëjë
5 me "Informacionin politik". Nuk është se do jua lexoj të
6 gjithë paragrafin këtu 15, por janë informatat politike, por
7 drejt fundit të këtij paragrafi thuhet që:

8 "Në RFJ, komandanti i korpusit të Prishtinës të Armatës
9 Jugosllave Gjenerali Lazareviq ka thënë se Armata Jugosllave
10 është gatshme të kthehet me forcë në Kosovë."

11 A ju kujtohen këto tensione, Dëshmitar?

12 PË. Nuk më kujtohet ky dokument konkret, por e di që ka patur
13 kërcënime të vazhdueshme të kësaj natyre.

14 PY. A ju kujtohet që edhe Gjenerali Clark ka qenë i
15 shqetësuar që serbët mund të rifuteshin në Kosovë ose që të
16 mësynin apo të përfshiheshin në beteja të tjera në Kosovë?

17 PË. Besoj që Gjenerali Clark ka qenë në dijeni të këtyre
18 raporteve. Nuk jam i sigurt në qoftë se i ka marrë seriozisht
19 apo jo sepse ne deri në një masë të caktuar më i konsideronim
20 këto si deklarata politike për të shpërqendruar vëmendjen.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam
22 përfunduar me pyetjet. Megjithatë në qoftë se do të bëjmë
23 pushimin tani duam që këtë të mund ta bëjmë për të parë dhe
24 një herë dokumentet dhe për të siguruar që nuk kam pyetje të
25 tjera për t'i bërë këtij dëshmitari.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
2 nuk ka kundërshtim mund ta bëjmë tani pushimin.

3 Nuk ka kundërshtime, kështu që, Dëshmitar, do të bëjmë
4 tani pushimin prej 30 minutash. Do kthehemi përsëri në orën
5 11.30 për të vazhduar me pyetjet për ju.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 --- Seanca ndërpritet në orën 10.53

9 --- Seanca rifillon në orën 11.30

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

11 Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

12 Znj. D'Ascoli, keni pyetje të tjera?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo. Por do ta përsërisë këtë
14 gjë në prani të dëshmitarit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht po
16 pyesja.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi

19 pothuajse në fund.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 D'Ascoli.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

24 PY. Zotëri, këto ishin pyetjet e mia. Konsultova planin tim,
25 nuk kam pyetje të tjera. Faleminderit për vëmendjen tuaj.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me kaq
2 përfundojnë pyetjet e mia.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
4 pyetje nga Mbrojtja?

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli:

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

8 PY. Z. Durkee, kam disa pyetje që lidhen me pyetjet që ju
9 bëri Prokuroria.

10 Juve ju bënë disa pyetje lidhur me ekzistencën e
11 paraushtarakëve serbë dhe kërcënimin e kthimit të forcave
12 serbe në Kosovë dhe që KFOR-i si rezultat i kësaj ishte
13 vendosur në gjendje alarmi. Ju kujtohen këto pyetje?
14 PË. Po.

15 PY. Nëse paraushtarakët serbë do ishin angazhuar në veprime
16 armiqësore dhe nëse Serbia do të kishte vendosur të dërgonte
17 trupat e saj në Kosovë si do të ishte përgjigjur KFOR-i?

18 PË. KFOR-i do të ishte përpjekur të mbronte territorin për të
19 zmbarsur dhe mposhtur forcat sulmuese dhe për të rivendosur
20 sigurinë, natyrisht, do të ishte kërkuar SHAPE, Komandës
21 Supreme të NATO-s për të dhënë forca, për t'i siguruar forca
22 shitesë.

23 PY. Mendoj që u përgjigjët pyetjes time vijuese, rihyrja e
24 Serbisë në Kosovë apo aktivizimi i paraushtarakëve serbë
25 brenda Kosovës do ta kishte vendosur KFOR-in nën gjendje

1 konflikti me Serbinë përsëri?

2 PË. Po.

3 PY. A ka diçka nga ato që dëgjuat sot nga Prokuroria që
4 ndryshon pikëpamjen, mendimin tuaj se konflikti i armatosur
5 midis UÇK-së dhe forcave serbe përfundoi më 20 qershor?

6 PË. Jo, vazhdoj të besoj të njëjtën gjë.

7 PY. Juve u pyetët disa herë -- dhe tani dua të kaloj tek një
8 temë tjetër. U pyetët për krimet e pretenduara të UÇK-së në
9 verën e 1999 në shkelje të marrëveshjes.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për shkak të kufizimeve të
11 vendosura nga dhënësi i informacionit, do të kërkoja të
12 kalonim në seancë private.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
14 seancë private, znj. Sekretare.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 62

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 63

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 64

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga znj. Tavakoli

Faqe 65

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike
4 tani.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim]

7 Pyetje nga Trupi Gjykses:

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi edhe një herë,
9 z. Durkee. Kam disa pyetje, uroj që të mos jenë të gjata.

10 Dje, gjatë marrjes tuaj në pyetje nga Mbrojtja e Thaçit,
11 na thatë se forcat serbe të organizuara u larguan nga Kosova,
12 besoj, që ishte 11 ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes
13 Tekniko-Ushtarake, në Kumanovë më 9 qershor 1999. Ju kujtohet
14 të keni thënë këtë?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe këtu për nevojat e
17 procesverbalit tonë, kjo gjendet në faqen e transkriptit
18 27999.

19 A mund t'ju pyes të na sqaroni edhe një herë për çfarë e
20 kishit fjalën kur flisnit për forcat e organizuara serbe,
21 bëhej fjalë këtu për ushtrinë serbe, MUP-in dhe forcat
22 policore?

23 PË. E kisha fjalën për forcat që ishin nën kontrollin e
24 drejtpërdrejtë të udhëheqjes institucionale të qeverisë në
25 Beograd, që ishin pjesë e Ushtrisë Jugosllave, Ministrisë së

1 Punëve të Brendshme dhe ata ishin njësitë zyrtare formale të
2 organizuara të qeverisë serbe.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E që të jemi
4 të qartë që ju kam kuptuar siç duhet, sot pak para orës 11.00,
5 pushimit të orës 11.00, duke ju përgjigjur pyetjes së
6 Prokurorit, ju thatë se ishit në dijeni në atë kohë se forcat
7 paraushtarake serbe kanë vepruar në Kosovë edhe përpara verës
8 së 1999, është e saktë?

9 PË. E saktë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka ndodhur kjo gjë me aq
11 sa keni dijeni ju pas tërheqjes së forcave serbe zyrtare të
12 organizuara?

13 PË. Nuk e kuptoj pyetjen.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni apo dini nëse
15 ka ndodhur kjo, pra, që forcat serbe, forcat paraushtarake
16 kanë vepruar në Kosovë edhe pas tërheqjes, siç e thatë të
17 forcave zyrtare ushtarake të Serbisë?

18 PË. Po. Ato kanë vepruar.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e
20 fundit lidhur me këtë temë është: A e dini nëse forcat e
21 organizuara zyrtare të rregullta dhe jo ato paraushtarake,
22 pra, ku kanë shkuar ato pasi janë tërhequr nga Kosova, u
23 kthyen në barakat e tyre, në kazermat e tyre apo kanë qëndruar
24 në afërsi të kufirit apo kanë shkuar diku tjetër? A dini
25 ndonjë gjë?

1 PË. Mendoj se trupat ushtarake që janë përdorur në Kosovë u
2 tërhoqën në zonën përtej kufirit por nuk janë shpërbërë dhe
3 dërguar në kazerma.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të
5 doja të kaloj në një temë tjetër. Në paragrafin 12 të
6 deklaratës suaj dhënë Mbrojtjes, ju keni thënë se ju kujtohet
7 takimi i marsit 1999 midis Gjeneralit Clark dhe delegacionit
8 të Kosovës në të cilin bënte pjesë z. Thaçi. A ju kujtohet të
9 keni diskutuar me Mbrojtjen këtë çështje dhe po ashtu edhe në
10 sallë të gjyqit dje dhe pardje?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më tej keni thënë në
13 deklaratën tuaj që i keni dhënë Mbrojtjes se:

14 "Synimi i këtij takimi ishte i dyfishtë."

15 Dhe po citoj:

16 "Së pari, Gjenerali Clark donte të njihte më mirë
17 kosovarët të cilët ai besonte do të ishin udhëheqësit e
18 ardhshëm të Kosovës. Dhe, së dyti, Gjenerali Clark ishte i
19 interesuar të kuptonte më mirë synimet, qëllimet politike të
20 UÇK-së dhe kapacitetet ushtarake në rast do të urdhërohej të
21 zhvillonte një operacion, të bënte një operacion ushtarak
22 atje."

23 Do doja t'ju pyes tani, z. Durkee, nëse kosovarët të
24 cilët Gjenerali Clark, ndoshta dhe ju, besonit do të ishin
25 udhëheqësit e ardhshëm të Kosovës përfshinin z. Thaçi?

1 PË. Po. Ne besonim këtë gjë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani a mund të
3 na thoni pse Thaçi mendohej se do të ishte udhëheqësi i
4 ardhshëm i Kosovës në mars të 1999-s?

5 PË. Neve krijuam përshtypjen se duke qenë i përfshirë në
6 delegacionin e Kosovës në negociatat në Rambuje dhe më
7 gjerësisht komuniteti ndërkombëtar, bashkësia ndërkombëtare e
8 perceptonte, e shihte atë si person me ndikim dhe udhëheqje
9 potenciale, pra, duke qenë se ishim në dijeni të lidhjes së
10 tij me UÇK-në pa qenë detyrimisht tërësisht në dijeni të
11 pozicionit të tij brenda UÇK-së, na dukej që ishte një
12 investim i mirë që të bënim përpjekje që të dinim më shumë dhe
13 të kuptonim më shumë personin në fjalë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në fund doli që ai u bë
15 udhëheqësi i Kosovës së pari si kryeministri i Qeverisë së
16 Përkohshme të Kosovës dhe më vonë si President i Kosovës --

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- pas luftës pra. Dhe sipas
19 paragrafit 13 të deklaratës suaj, që i keni thënë Mbrojtjes së
20 z. Thaçi, i keni thënë Mbrojtjes se "Z. Thaçi u prezantua vetë
21 si udhëheqësi i delegacionit". A ju kujtohet të keni thënë
22 këtë Mbrojtjes?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të di nga ju
25 si e keni, si e bëri këtë gjë, si u prezantua Thaçi juve dhe

1 Gjeneralit Clark?

2 PË. Mesa më kujtohet takimi, të nderuar, Thaçi hyri dhe
3 filloi të prezantojë anëtarët e tjerë dhe pastaj u ulëm dhe ai
4 mori pozicionin drejtpërdrejt, pra, vendin drejtpërdrejt
5 përballë Gjeneralit Clark që është normalisht vendi që merret
6 nga udhëheqësi i njerëzve në anën tjetër, i palës tjetër.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe referenca si udhëheqës i
8 delegacionit, referenca që të jemi të qartë në këtë pikë,
9 ishte delegacioni në Rambuje, delegacioni i Kosovës?

10 PË. Po. Kërkoj ndjesë. Ajo që doja të thoja është që ai ishte
11 udhëheqësi i grupit që erdhi në takimin në Mons.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kaq kisha
13 nevojë të dija.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
15 Mettraux.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

17 Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Do të vazhdojmë me takimin në
18 Mons për një çast. Ju thatë kur ju tregua raporti i parë dje,
19 që ishte ribotuar nga BBC-ja pas takimit dhe ju theksuat aty
20 disa pasaktësi në raport. Ju kujtohen këto pyetje?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Desha t'ju pyes nëse ka
23 patur ndonjë arsye të veçantë përse takimi midis delegacionit
24 dhe Gjeneralit Clark nuk u bë në shtabin në Mons, por në bazën
25 ajrore, bazën ushtarake ajrore? E shoh që po buzëqeshni dhe

1 mund ta dini.

2 PË. Po. Ishte një protokoll për vizitorët e huaj në shtab sa
3 i takon si -- mënyra se si do të bëhej takimi, që për të
4 shkuar në ndërtesë, për të shkuar në zyrën e Gjeneralit Clark.
5 dhe ishte një lloj përmbajtje ceremoniale, pra, mënyra se si
6 trajtoheshin vizitorët e huaj për t'i trajtuar si persona të
7 rëndësishëm.

8 Ne nuk ishim akoma të bindur se ne do të takoheshin me
9 persona që ishim takuar në Rambuje në të njëjtën mënyrë. Ne
10 donim që t'i dinim, që t'i njihnim ata. Donim që të kuptonim
11 kush ishin ata, të mësonim më shumë, të dinim më shumë për
12 synimet, qëllimet e tyre, planet e tyre dhe nuk donim që t'i
13 legjitimonim ata detyrimisht. Pra, u vendos që takimi të
14 mbahej në bazën ushtarake ajrore në një dhomë konferencash të
15 vogël.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes lidhur
17 me diçka që ju tha sot në mëngjes. Juve ju bënë pyetje për
18 drejtorinë politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
19 thatë që "është ndarë natyrisht nga Shtabi i Përgjithshëm".
20 Dua të kuptoj pak më shumë bazën dhe arsyet e deklaratës tuaj
21 lidhur me këtë.

22 A e dini nëse drejtoria politike ishte pjesë përbërëse e
23 Shtabit të Përgjithshëm në 1998 dhe në 1999?

24 PË. Kjo pyetje kërkon një shpjegim pak më të gjerë, në
25 ushtritë perëndimore nuk ka drejtori politike brenda Shtabit

1 të Përgjithshëm. Në vendet e paktit të Varshavës ushtritë e
2 tyre kanë, siç ishte Ushtria Jugosllave, për shembull, kanë
3 një element politik në Shtab të Përgjithshëm. Pra, neve
4 kuptuam që shqiptarët e Kosovës kishin imituar atë, strukturat
5 e Ushtrisë jugosllave.

6 Dhe megjithatë, ne lexuam shtypin, lexuam lidhur me
7 drejtorinë politike, po bënim ku bëhej përpjekje për të
8 paraqitur drejtorinë politike si më të rëndësishme dhe më të
9 lartë se Shtabi i Përgjithshëm që për një ushtarak është
10 ngatërruese dhe krijon konfuzion. Pra, ajo paraqitej sikur
11 ekziston, Thaçi përshkruhej si udhëheqësi i drejtorisë
12 politike por ne nuk kuptonim qartë marrëdhënien midis
13 elementit civil dhe luftëtarëve, në veçanti luftëtarët në
14 terren në Kosovë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nuk dua në asnjë
16 mënyrë që ta shpreh këtë si kritikë, por a e kuptoj përgjigjen
17 tuaj, siç e shpjeguat ju apo atë që mendonit ju, është e
18 bazuar në mënyrën se si funksionojnë këto gjëra në kohë
19 normale? A e kuptoj që për sa i përket Shtabit të Përgjithshëm
20 të UÇK-së ju nuk jeni në gjendje të pohoni me saktësi se ku
21 ishte i vendosur? A është kështu?

22 PË. Kështu është.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe po t'ju them që
24 struktura është ndërtuar brenda Shtabit të Përgjithshëm, a
25 jeni në gjendje ju të jepni ndonjë koment për këtë a është e

1 saktë apo jo? Ju nuk jeni në gjendje, pra, që të jepni një

2 koment nëse kjo është e saktë apo jo?

3 PË. Kështu është.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe që të shkojmë më tej
5 lidhur me këtë çështje, a ishit në dijeni ju në atë kohë se
6 kush ishin drejtorët e ndryshëm të Shtabit të Përgjithshëm, të
7 drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së apo jeni në
8 dijeni ju për funksionin e Thaçit lidhur me këtë?

9 PË. Ne e dinim për Thaçin. Ne dinim gjithashtu që ishte një
10 person i identifikuar si zëdhënës i UÇK-së dhe ky ishte Jakup
11 Krasniqi.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po vazhdojmë pak më tej me
13 njohuritë që kishit ju për të verifikuar njohuritë në atë kohë
14 a ishit në dijeni të faktit se drejtori i këtyre drejtorive
15 mund të kenë qenë pjesëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, pra,
16 me fjalë të tjera, drejtorë të drejtorive të ndryshme ishin
17 dhe pjesëtarë, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm apo ishte
18 informacion që ju nuk e kishit?

19 PË. Në kohën e takimit në Mons, ne nuk e kishim këtë lloj
20 qartësie.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, aq sa keni dijeni
22 ju, siç mund a kuptoni ju, si e keni kuptuar ju apo si e keni
23 kuptuar, pra, rolin dhe funksionin e drejtorisë politike?

24 PË. Nuk ka elementë krahasues të ngjashëm në përfundim për
25 këtë lloj strukture. Pra, neve na dukej duke lexuar deklaratat

1 publike se kjo ishte një drejtori politike, kjo drejtori
2 politike i jepte udhëzime Shtabit të Përgjithshëm. Dhe,
3 megjithatë, po të kishte qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm
4 do të ishte një kundërshtim, ishte kundërthënie, pra, ishte
5 ngatërruese për ne, nuk kuptohej, ishte e paqartë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam edhe disa pyetje
7 lidhur me diçka tjetër me të cilët ju u morët për lëvizjet dhe
8 kërkesat që Gjenerali Jackson bëri ndaj z. Thaçi dhe z. Çeku
9 lidhur me atë që mendohej që ishin aktivitete, veprimtari
10 kriminale të UÇK-së.

11 Ju kujtohen këto pyetje?

12 PË. Po, më kujtohen.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe duke iu përgjigjur
14 njëres prej këtyre pyetjeve, ju latë të kuptohej sipas asaj që
15 keni kuptuar, ju siç ishte në atë kohë se komandantët e zonave
16 kishin pavarësi në një shkallë relativisht të madhe. Ju
17 kujtohet që keni thënë këtë?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe dua të kuptoj këtë pse
20 sipas jush, mesa keni kuptuar ju, Gjenerali Jackson do të
21 shkonte tek z. Çeku dhe z. Thaçi për të zgjidhur këto çështje,
22 këto probleme? Pse nuk do të shkonte tek komandantët e zonave
23 atëherë? Në qoftë se e dini, natyrisht.

24 PË. Besoj se nga pikëpamja e Gjeneralit Jackson, ai duhej të
25 merrej me personat dhe ta trajtonte këtë çështje me personat

1 me të cilët kishte negociuar zbatimin e Marrëveshjes së
2 Angazhimit dhe ata ishin Çeku dhe Thaçi. Pra, nuk do të kishte
3 qenë e vendit në bazë të protokollit ushtarak që ai të shkonte
4 në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të takonte komandantët vartës
5 të tyre. Ai këtë do t'ia linte komandantëve të tij vartës,
6 pra, komandantëve të brigadave në terren më shumë dhe jo që ta
7 bënte vetë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, është e saktë që të
9 themi edhe këtu, për të përdorur fjalët tuaja, por ju që
10 mendonit, Gjenerali Jackson mendonte nga ajo që po thoni ju,
11 që ju kuptonit, pra, kuptohej që mund të sigurohej respektimi
12 i marrëveshjes në radhët e ushtrisë, pra, më poshtë përmes
13 tyre?

14 PË. Pastaj duhet të kthehemi në fakt tek negociatat që u bënë
15 lidhur me marrëveshjen që mund të miratoheshin vetëm pas
16 konsultimit dhe pranimi nga ana e komandantëve të zonave.
17 Pra, për t'u përgjigjur po, ai po i bënte presion tek
18 udhëheqja e nivelit të lartë, por kuptimi ishte se ata u
19 angazhuan për marrëveshjen dhe duhet të kërkonin dhe të
20 merrnin miratimin e komandantëve të zonave dhe t'i bënin
21 thirrje atyre në bazë të angazhimit të tyre për t'u marrë, për
22 të shmangur shkeljet e marrëveshjes të cilët ata kishin
23 pranuar. Pra, kjo ishte një përpjekje për t'u përgjigjur sipas
24 zinxhirit të duhur ushtarak, duke pranuar në të njëjtën kohë
25 se komandantët e zonave ishin bashkëpunues dhe respektonin

1 këtë gjë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto ishin
3 pyetjet e mia.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
5 Gaynor.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

7 Vetëm disa pyetje kam unë. Dua të shoh pak më tej
8 çështjen e forcave paraushtarake serbe që ishin në Kosovë pas
9 tërheqjes së Ushtrisë Jugosllave dhe forcave të MUP-it të
10 Serbisë.

11 Mendoj që ju u pajtuat me Gjykatësin Barthe se ju ishit
12 në dijeni që këto forca po vepronin?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A i dini emrat e këtyre
15 forcave paraushtarake serbe?

16 PË. Është interesat që të shihet në krahasimet me situatat që
17 kemi gjetur -- të bëjmë një krahasim me situatën që kemi
18 gjetur në Bosnjë pas zbatimit të marrëveshjes së Dajtonit
19 sepse edhe atje kemi gjetur mbetjet e fundit të
20 paraushtarakëve të cilët vepronin në bashkëpunim me Ushtrinë
21 Jugosllave dhe forcat e MUP-it të cilat kishin mbetur akoma
22 aty dhe kishte kaq shumë emra fantazistë siç janë Tigrat e
23 Arkanit, Djemtë e Frenkit. Frenki Simatovic mendoj se e kishte
24 emrin.

25 Pra, ne nuk e dinim saktësisht se kush kishte ngelur në

1 Kosovë. Kishim elementë aktivë në Kosovë gjatë konfliktit dhe
2 disa prej tyre kishin ngelur akoma aty.

3 Pra, është një situatë ku është shumë e vështirë për
4 shërbimet e zbulimit që të kuptojnë, të marrin informacione të
5 drejtpërdrejta për nivelin e veprimtarisë dhe të aktivitetit.
6 Mendoj, në përgjithësi, Kosova gjatë periudhës ishte kaotike
7 dhe kishte shërbime të zbulimit të ndryshme perëndimore që
8 përpiqeshin të krijonin dhe të zhvillonin rrjet informacioni
9 siç kemi bërë edhe ne përmes KFOR-it.

10 Pra, ne e dinim që kishte elementë paraushtarakë që
11 kishin ngelur aty. Ishte një aktivitet për të marrë
12 informacion konkret lidhur me vendin ku ndodheshin,
13 kapacitetet e tyre dhe qëllimet e tyre.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që të përqendrohemi tani
15 vetëm në periudhën pas tërheqjes së Ushtrisë Jugosllave dhe
16 forcave të MUP-it, a e dinit ju cilat lloj aktivitetesh po
17 zhvilloheshin aty?

18 PË. Ata po bënë presion, për shembull, serbët po bënë --
19 serbët që kishin ngelur në Mitrovicë, në zonën e Mitrovicës në
20 Veri të Kosovës, po bënë presion tek serbët që të mos
21 bashkëpunonin me UNMIK-un dhe me KFOR-in sepse dëshironin që
22 të mbanin kontrollin serb në këto territore.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe mesa dinit ju, ndonjë
24 prej këtyre forcave paraushtarake a mori pjesë në veprime
25 armiqësore të ndonjë lloj natyre pas tërheqjes së forcave të

1 ushtrisë jugosllave?

2 PË. Në qoftë se fjala ka të bëjë me veprime armiqësore ndaj
3 KFOR-it nuk besoj të ketë ndodhur. Veprimet e tyre ishin të
4 drejtuara kundër elementëve civilë të popullsisë.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkojmë pak më larg lidhur
6 me këtë. A ishin veprimet e tyre të fuqishme apo përdorën
7 armë?

8 PË. Ata kanë qenë sigurisht të armatosur. Nuk më kujtohen
9 incidente apo ngjarje konkrete ku është përdorur dhunë me
10 armë, por kërcënimi ishte i pranishëm. Dhe, natyrisht, ne po
11 merreshim, ishim përballë elementëve serbë, elementë civilë
12 serbë të cilët vetë ishin të shqetësuar për të ardhmen dhe
13 shpresonin të merrnin mbështetjen e serbëve për t'i mbrojtur
14 ata.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe a kuptuat gjatë kësaj
16 periudhe kohore nëse ndonjë prej këtyre forcave paraushtarake
17 serbe ishin të përfshirë në ndonjë veprim armiqësor ndaj
18 forcave të UÇK-së të cilët ishin në procesin e demobilizimit?

19 PË. Mendoj se në atë kohë ishte një ndarje *de facto* e
20 forcave. Serbët ishin më shumë të përqendruar në pjesën
21 veriore të Kosovës. UÇK-ja ishte në mes, ishte në procesin e
22 grumbullimit, në zonat e grumbullimit dhe demobilizimit në
23 përputhej me kushtet e marrëveshjes. Pra, *de facto* nuk ka
24 patur mundësi që të keni kontakt të drejtpërdrejtë.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe a ju kujtohet ndonjë

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vjuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli

Faqe 79

1 vlerësim lidhur me mënyrën sesi individët në forcat

2 paraushtarake serbe kanë vepruar akoma në atë kohë?

3 PË. Jo.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ka dalë dokumenti në fjalë. Më
5 jepni një çast, ju lutem.

6 Pyetje vijuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli:

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

8 PY. Z. Durkee, dëshironi të çoheni?

9 PË. Po.

10 PY. Se më thanë që mund të keni nevojë të çoheni herë pas
11 here.

12 PË. Jam në rregull.

13 PY. Gjykatësi Mettraux ju tha që se Gjenerali Jackson nuk ka
14 shkuar tek komandantët e zonave për të marrë pëlqimin e tyre.

15 A keni dijeni nëse Gjenerali Jackson këmbënguli që komandantët
16 e zonave të ishin të pranishëm?

17 PË. Nuk e di çfarë udhëzime u ka dhënë ai komandantëve apo
18 komandantëve të zonave.

19 PËRKTHYESJA: Transkripti nuk punon.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Tavakoli, pyetja nuk
21 ishte e përgjithshme. Ishte për incidentin që e pyetët ju për
22 një dhunë të pretenduar prej UÇK-së.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

24 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

1 PY. A e dini që në takimet e KPI-së ku kanë qenë të pranishëm
2 dhe komandantët e zonave, Jackson i ka ngritur çështjet e
3 dhunës dhe ka kërkuar që të respektohej marrëveshja?

4 PË. Nuk më kujtohet konkretisht ndonjë raport i tillë. Po ma
5 merr mendja që Jackson e ka bërë diçka të tillë.

6 PY. Po pse do ta bënte ai diçka të tillë në praninë e
7 komandantëve të zonave?

8 PË. Sepse ishte në kontekstin e këshillit për zbatimin e
9 përbashkët, ishte krejt normale që ai të komunikonte me
10 personat që merrnin pjesë në këtë takim. Po kjo ndryshon nga
11 rastet kur shkonte në terren dhe takonte drejtpërdrejt
12 komandantët e zonave apo komandantin Çeku.

13 PY. Faleminderit. Pyetja e radhës: A e dini ju se Gjenerali
14 Jackson ka dhënë deklaratat për shtypin në gusht të 1999, ku
15 është shprehur se ishte i shqetësuar se udhëheqja e UÇK-së nuk
16 kishte kontroll mbi persona të caktuar në UÇK?

17 PË. Po.

18 PY. A përputhet kjo edhe me pikëpamjen tuaj?

19 PË. Po, sepse ne e dinim që disa komandantë të zonave nuk e
20 pranonin marrëveshjen e demobilizimit. Ata mendonin se ishin
21 elementët që do të udhëhiqnin Kosovën drejt pavarësisë dhe se
22 kishin qenë pjesë të fushëbetejave dhe nuk donin të hiqnin
23 lehtë nga roli i tyre thjesht se ua kërkonte komuniteti
24 ndërkombëtar.

25 Mbjaj mend që ne jemi mbështetur shumë tek fakti se gjatë

Dëshmitari: Michael Durkee (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vjuese të mëtejshme nga znj. Tavakoli

Faqe 81

1 negociatave që bëmë për këtë marrëveshjen e demobilizimit,
2 komandantët e zonave u konsultuan paraprakisht, të paktën një
3 grup prej tyre ishin të gatshëm ta pranonin dhe ta respektonin
4 marrëveshjen. Kur u kthyen në shtëpitë tyre konstatuan se
5 shumë prej luftëtarëve ishin shumë të pakënaqur me vendimin e
6 tyre dhe pati trysni të brendshme, fraksione të brendshme,
7 disa ishin bashkëpunues, por të tjerë nuk ishin.

8 PY. Faleminderit, z. Durkee. Kaq pyetje kisha unë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Durkee,
12 mbaruat me ne.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
15 që erdhët. Faleminderit për përgjigjet tuaja. Faleminderit që
16 respektuat rregulloren e Gjykatës dhe ju urojmë gjithë të
17 mirat.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Uroj të kem folur ngadalë për
19 përkthyesit. Se e di që kanë punë shumë të vështirë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 [Dëshmitari largohet]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Takohemi të hënën në mesditë të fillojmë me dëshmitarin
24 tjetër. Keni ndonjë parashtim? Në rregull. Nuk ka asgjë.

25 Në rregull. Shihemi të hënën në mesditë.

1 --- Seanca mbyllet në orën 12.08

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25